



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PAKR.nr.177/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Vaton Durguti , kryetar, Dr.sc.Driton Muharremi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve S.A. nga Gjilani për shkak të veprave penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së si dhe vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 par.1 të KPRK-së, si dhe të akuzuarit B.M. nga Gjilani për shkak të veprave penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.2 lidhur me par.2 nënpar.2.1 dhe nenin 12 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së , duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.61/2019 dt. 17.12.2020, me datë 16.06.2021 morri këtë :

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.61/2019 dt. 17.12.2021, ndryshohet vetëm përkritazi me vendimin mbi dënim për të akuzuarin S.A. ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarin S.A. për veprën penale nën pikën I.a të dispozitivit të aktgjykimit për të cilin është shpallur fajtor e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muaj për veprën penale nën pikën I.b për të cilën është shpallur fajtor e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1(një) vit e 10(dhjetë) muaj ndërsa për veprën nën pikën I.c për të cilën është shpallur fajtor i'a merr si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro ashtu që konform nenit 80 të KPRK-së i shqipton dënimin unik me burg efektiv në kohëzgjatje prej 2(dy) viteve dhe dënimin me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 05.03.2019 deri më datën 03.04.2019 si dhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës 04.04.2019 deri më datën 07.05.2019. Pjesa tjetër e aktgjykimit ngel e paprekur.

II. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan përkritazi me të akuzuarin B.M..

A r s y e t i m

Gjykata Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, me aktgjykimin PKR.nr.61/2019 dt. 17.12.2020, I. të akuzuarin **S.A.** e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.3 lidhur me par.1 dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës

penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj , e ka shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumën prej gjashtëqind (600) euro , dhe e ka gjykuar me **dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy) viteve** dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në afatin verifikues prej 3(tri) viteve, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të revokimit të këtij dënimi në kuptim të nenit 53 dhe 54 të KPRK-së dhe **dënim me gjobë** në shumën prej **gjashtëqind (600) euro**, të cilin i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej tre muajve në pjesë të barabarta prej nga 200 euro , duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mirpo nëse eventualisht i akuzuari S. nuk mund ta paguaj ose nuk dëshironë që ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti, i zëvendësohet në dënim me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve, të cilin duhet ta filloj ta mbaj në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve duke filluar nga dita pasuese e pranimit të ftesës së kësaj gjykate për mbajtjen e dënimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Në kuptim, të nenit 83 par.1 të KPRK-së të akuzuarit S. në dënimin e lartcekur i llogaritet koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 05.03.2019 e gjer më datën 03.04.2019 si dhe periudha kohore e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 04.04.2019 gjer më 07.05.2019. Detyrohet i akuzuari S.A. që në emër të shpenzimeve të procedurës penale edhe atë për dy ekspertizat mjeko-ligjore të paguaj shumën prej 80,99 euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej njëqind (100) euron ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej 30 diteve, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërie së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. **II:** Të akuzuarin **B.M.** e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve dhe i ka shqiptuar **dënimin me gjobë** në shumën prej **gjashtëqind (600) euro** të cilin i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej tre muajve në pjesë të barabarta prej nga 200 euro , duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mirpo nëse eventualisht i akuzuari nuk mund ta paguaj ose nuk dëshironë që ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti, i zëvendësohet në dënim me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve, të cilin duhet ta filloj ta mbaj në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve duke filluar nga dita pasuese e pranimit të ftesës së kësaj gjykate për mbajtjen e dënimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Në kuptim, të nenit 83 par.1 të KPRK-së të akuzuarit B. në dënimin e lartcekur i llogaritet koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 05.03.2019 e gjer më datën 02.05.2019. Detyrohet i akuzuari B.M. që në emër të shpenzimeve të procedurës penale edhe atë për paushallin gjyqësor prej shtatëdhjetë (70) euro ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej 30 diteve, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërie së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Ndërsa në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.2 të KPP-së lidhur me nenin 12 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për shkak të rrethanës së mbrojtjes së nevojshme e cila përjashton përgjegjësinë penale të këtij të akuzuari e ka **liruar nga akuza** për veprën penale lëndim i rëndë trupor në kuptim të nenit 186 par.3 nënpar 3.2 lidhur me par.2 nënpar 2.1 dhe nenin 12 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Përkitazi me këtë vepër penale shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të KGJK-së së Prishtinës. **III** Në kuptim të nenit 374 par.3 të KPRK-së si dhe nenit 282 par.1 të KPP-së KONFISKOHEN një pistoletë e markës “Zavodi Crvena Zastava” me numër serik 37419, me kalibër 9mm, një sprej “OC”, një kapelë maskë me ngjyrë të zezë dhe një karikator, një sopatë (sakicë), një maskë ngjyrë e zezë, një sprej OC si dhe një briskë ngjyrë hiri të sekuestruara nga të akuzuarit e lartcekur sipas formularit për dëshmi NJHR # 019-19 2019 CA 00229 të datës 04.03.2019, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi përmes komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate do të shkatërrohen. **IV.** Urdhërohet për ekzekutimin e sanksioneve penale i kësaj gjykate që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi t’i kthehen të akuzuarit S. A. të dhëna tjera personale si më lartë edhe atë paratë e sekuestruara si në vijim : 61.95 Euro, 330 dinarë dhe 2 franga

zvicërone si dhe një letërnjoftim i Serbisë si dhe një portofol ngjyrë e zezë, të sekuestruara sipas formularit për dëshmi NJHR # 019-19 2019 CA 00229 të datës 04.03.2019.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

- Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënimin lidhur me të akuzuarin S.A., dhe të njëjtin ta dënojë me burgim efektiv, ndërsa sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit ndaj të akuzuarit B.M., lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

-Përgjigjie ndaj ankesës së PTH ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit S.A. av. Zijadin Spahiu me propozim që ajo të refuzohet si e pabazuar.

-Përgjigjie ndaj ankesës së PTH ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit B. M. av. Enver Halili me propozim që ajo të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit caktoi seancën e kolegjit duke njoftuar palët për datën dhe vendin e mbajtjes së seancës, ku prezantuan të akuzuarit S.A. dhe B.M. si dhe mbrojtësit e tyre av. Zijadin Spahiu dhe av. Enver Halili, ndërsa munguan Prokurori i Apelit dhe i dëmtuari L. H.. Mbrojtësit kundërshtuan ankesën e Prokurorisë dhe mbetën pranë përgjigjive me shkrim të ushtruara kundër ankesës së Prokurorisë. Të akuzuarit mbështetën mbrojtësit e tyre.

-Prokurori i Apelit në parashtresën PPA/I.nr.182/21 të dt. 06.05.2021 ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarin S.A. ta dënoj me burg efektiv ndërsa sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit për të akuzuarin B.M. lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Të refuzohen përgjigjet në ankesën e PTH e mbrojtësve të Akuzuarve S.A. av. Zijadin Spahiu dhe B. M. av. Enver Halili si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës konform nenit 394 par.1 të KPP-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit dhe gjeti se :

-ankesa e Prokurorisë për të akuzuarin S.A. është e bazuar ndërsa për të akuzuarin B.M. është e pabazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet nga ana e Prokurorisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi sa i përket pjesës liruese dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin dhe me provat e shtjelluara gjatë shqyrtimit gjyqësorë.

Edhe gjendjen faktike e atakon me arsyetim se veprimet e të pandehurit përmbushin elementet e veprës penale të lëndimit të rëndë truporë në rrethana të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme, meqë intensiteti i mbrojtjes nuk ka në proporcion me shkallën e rrezikut që e ka paraqitur sulmi. Përkundër që i pandehuri B. ka qenë i sulmuar dhe se me të pandehurin S.A. kanë qenë në raporte të këqija në mes veti, i pandehuri B. ka mundur që ta evitoj sulmin dhe mos ti shkaktoj pasoja të rënda të pandehurit S. edhe pse ka qenë i sulmuar me mjete të forta ashtu që konsiderojmë se përdorimi i armës është tejkalim i mbrojtjes së nevojshme.

Gjykata e Apelit e Kosovës me vëmendje ka shqyrtuar ankesën e Prokurorisë si dhe shkresat e lëndës dhe ka vlerësuar se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që aktgjykimi është i qartë dhe konkret, Gjykata ka dhënë arsyet për faktet vendimtare duke vlerësuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha në përputhje me njëra tjetrën duke dhënë vlerësimin për gjendjen faktike të cilën si të tillë e përkrahë edhe kjo Gjykatë.

Sa i përket gjendjes faktike Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat materiale dhe ato personale duke dëgjuar dëshmitaren V.H., B.H. dhe E.H, leximin e deklaratës së dëshmitarit L.H. dhënë në Prokurori, pastaj nga provat materiale ekspertizën mjeko ligjore lidhur me natyrën e lëndimeve për dy të akuzuarit, dëftesa mbi konfiskimin e provës 05.03.2019, raporti mbi tërheqjen e automjetit të së njëjtës datë, formular prone - dëshmie të datës 05.03.2019, të dhënat nga databaza e policisë për të akuzuarin B.M., raporti i oficerëve policorë dhe shikimi në foto dokumentacion dhe se nga këto prova pa mëdyshje u vërtetua vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari B.M. sa i përket veprës penale lëndim i rëndë truporë e ka kryer në mbrojtje të nevojshme. Nga këto prova shihet se i akuzuari i parë S.A. ka pranuar fajësinë për të tri veprat penale e ndër to edhe për pranimin e fajësisë për vrasje në tentativë të B. M. dhe në anën tjetër mënyra se si është kryer vepra penale ku i akuzuari B.M. ka qenë në veturë së bashku me dëshmitaren V., në një vend ku ka qenë errësirë ka ardhur një veturë tjetër në të cilën ka qenë i akuzuari S. dhe tre persona të tjerë të maskuar, dhe është sulmuar me sopat duke i shkaktuar lëndime si në raportin e ekspertizës mjeko ligjore dhe duke qëndruar i dëmtuari – i akuzuari B. në një pozitë të pa lakmuar dhe i sulmuar nga një sulm i kundërligjshëm me mjete të rrezikshme siç është sopata dhe i gjetur në një situatë të tillë pra i ulur në veturë dhe i sulmuar nga këta persona me sopat dhe shufra metalike, kjo Gjykatë ashtu siç ka vlerësuar edhe Gjykata e shkallës së parë i akuzuari B.M. ka krijuar një mbrojtje të domosdoshme për ta zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetës dhe duke pas parasysh se ishte sulmuar me sopat e cila paraqet një mjetë të rrezikshëm për privim nga jeta, faktin se ishte i sulmuar nga disa persona që kishin shufra metalike, i njëjti nuk kishte provokuar sulmin e as që i ka njohur sulmuesit pasi që ishin të maskuar, se sulmi logjikisht ka shkaktuar te i dëmtuari gjendje të tronditur shpirtërore dhe i frikësuar për jetën e tij, vërteton gjetjet e shkallës së parë se i njëjti ka kryer veprën penale në mbrojtje të nevojshme e jo siç pretendon prokuroria se në këtë rast kemi pasur tejkalim të mbrojtjes së nevojshme. Pra në këtë rast ka ndodhur edhe sulmi i drejtuar ndaj jetës së tjetrit i cili ishte i kundërligjshëm, i atëçastshëm dhe real dhe në anën tjetër kemi mbrojtjen për të zbrapsur këtë lloj sulmi e që të dyja këto edhe sulmi edhe mbrojtja janë kushte që përmbushin mbrojtjen e nevojshme në formën dhe mënyrën se si ka ndodhur në rastin konkret.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të prokurorisë lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa e prokurorisë për të akuzuarin S.A. është e bazuar ndërsa për të akuzuarin B.M. është e pabazuar. Prokuroria thekson në ankesë se dënimi për të akuzuarin S. është tejet i butë dhe me dënime të tilla nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit. Gjykata ka theksuar rrethanat lehtësuese mirpo janë edhe rrethanat tjera rënduese që tregojnë se i akuzuari S. veprat i ka kryer për motive të ulëta dhe në shenjë hakmarrje. Sa i përket të akuzuarit B.M. për të njëjtin është ushtruar ankesë për shkak të pjesës liruese për të cilën gjykata e ka e ka liruar të njëjtin.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh pretendimet ankimore të prokurorisë si dhe duke pas parasysh mënyrën dhe rrethanat në janë kryer veprat penale dhe atë për pikën I.a duke shtënë me armë zjarri 4 here në veturë ku ishte i dëmtuari L.H. dhe B.M. dhe persona të tjerë të rastit ndërsa për veprën nën pikën I.b duke sulmuar me persona të tjerë të maskuar dhe me mjete të rrezikshme si sopata dhe shufra metalike, duke shkaktuar lëndime trupore, kjo Gjykatë vlerëson se dënimet e shqiptuara nga ana e Gjykatës së shkallës së parë janë tejet të

buta prandaj edhe ndryshoj aktgjykimin përkitazi me vendimin mbi dënim duke i shqiptuar të akuzuarit dënim me burg efektiv si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilin dënim është i bindur se është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këto dënime mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të ligjit penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 dhe 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.177/21, më 16.06.2021

Procesmbajtëse,
Leonita Lajçi_____

Kryetar i kolegjit- gjyqtari
1. Vaton Durguti_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Afrim Shala_____